Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01-431
Datë: 30.07.2018

Në mbështetje të neneve 15, pika 2, dhe nenit 17, pikat 1.5, 1.6 të Ligjit nr. 03/L-060 mbi Kualifikimet Kombëtare dhe Udhëzimit Administrativ nr. 35/2014 të datës 20. 11. 2014 mbi Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me nenet 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, dhe 18, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve me datë 17.07.2018, nxjerr këtë:

VENDIM

1. Miratohet aplikacioni për validim, akreditim dhe raporti i vetëvlerësimit për Qendrën e Kompetencës në Skenderaj, me kualifikimet:

    - Instalues i ngrohjes qendrore; dhe
    - Instalues i ujësjellësit dhe kanalizimit.

2. Këshilli Drejtues rekomandon AKK që të vazhdojë me procesin sipas legjislacionit në fuqi.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

4. Vendimi u dërgohet:
    - Qendrës së Kompetencës në Skenderaj ; dhe
    - AKK.

Kryetari i KD së AKK
Bedri Xhafa